



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:084789  
Datë: 20.06.2024  
Numri i dokumentit: 05839515

**K.Dh.Shk II.nr.336/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përbarimore të kreditorit “Ameba” SH.P.K., me NUI: 811444843, me seli në Suharekë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.R.R., avokate në Suharekë, kundër debitorit A.R.B. B.I. - (N.T.SH. Unisoft), me NUI: 810201294, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.11/23 të datës 19.09.2023, me datë 20.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Ameba” SH.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr. 11/23 të datës 19.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 11/23 të datës 19.09.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të A.R.B. B.I. - (N.T.SH. Unisoft), kundër Urdhrit për Përbarim

P.nr.1443/22 të dt. 11.11.2022 të Përmbauesit Privat Mehdi Reshani, dhe i njëjti Urdhër për përmbaerim është Shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit të procedurës përmbaerimore, vërtetimit të gabuara dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimi të gabuar të së drejtës procedurale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr. KPPP.nr.11/23 të datës 19.09.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar debitori

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaerimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Ameba” SH.P.K., me datën 11.11.2022, ka paraqitur propozimin për përmbaerim në bazë në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 8 të datës 31.10.2022 dhe Faturës Nr. 9 të datës 31.10.2022; me të cilin e ka urdhëruar debitorin që sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 3,505.00 € (tremijë e pesëqind e pesë euro), me kamatë ligjore prej 8% nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, ashtu që realizimi të bëhet përmes bllokimit të llogarive bankare, regjistrimit, sekuestrimit dhe shitjes të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Përmbauesi Privat Mehdi Reshani me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit për përmbaerim të kreditorit me urdhrin përmbaerimor P.nr. 1443/2022 të dt. 11.11.2022 e ka lejuar përmbaerimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbaerimor P.nr. 1443/2022 të dt. 11.11.2022 duke theksuar ndër të tjerash se me datat 09.12.2022 dhe 29.12.2022 e ka paguar borxhin sipas faturave të pranuar, përkundër faktit

që faturat nuk kanë pasur afat për përmbushje të këtij detyrimi. Gjykatës i ka propozuar që të miratohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të konstatohet se përmbaruesi privat ka vepruar me parregullsi gjatë udhëheqjes së procedurës së kësaj çështje përmbarimore, të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t’ia paguajë shpenzimet për përpilimin e prapësimin në vlerë prej 104.00 € sipas TOAK. Po ashtu Kreditori, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësim, duke theksuar ndër të tjerash se kreditori i ka dhënë afatin 3 ditor debitorit që ta përmbush obligimin. Ka shtuar se të gjitha pretendimet e debitorit kanë për qëllim vetëm zvarritjen e procedurës përmbarimore. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjen e kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejme: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim: Gjykata vlerëson se në rastin konkret Faturën Nr. 8 të datës 31.10.2022 dhe Faturën Nr. 9 të datës 31.10.2022, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura Nr. 8 e datës 31.10.2022 dhe Fatura Nr. 9 e datës 31.10.2022, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbarim dhe është lejuar urdhri përmbarimor është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore,

prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, gjen se sipas shkresave të lëndës, urdhri për përmbarrim i lëshuar nga përmbarruesi Privat P.nr.1443/2022 i datës 11.11.2022, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarrim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm ashtu si që është parapar me nenin 37 të LPP-së, me të cilën parashihet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkangjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopje e tij e vërtetuar sipas ligj.*

Andaj, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarrim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, ngase Fatura me Nr. 8 të datës 31.10.2022 dhe Fatura me Nr. 9 të datës 31.10.2022, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së,

Po ashtu, kjo gjykate vlerësoi pretendimet ankimore por që të njëjtat i refuzoj si të pa bazuar si në arsyetim të këtij aktvendimi, ngase faturat në fjalë të dorëzuar jo që nuk janë në origjinal por as kopja e tyre nuk është e vërtetuar, andaj, si të tilla janë të pa përshtatshme për përmbarrim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K.DH.SH.II.nr.336/24, me datë 20.06.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri